



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 1721 prot.

Tiranë, më 15.10.2025

URDHËR

Nr. 125, datë 15 / 10 /2025

PËR
MARRJEN E MASAVE PËR ORGANIZIMIN DHE ADMINISTRIMIN E
KONKURSEVE TË PRANIMIT PËR RAUNDIN E III-TË
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Udhëzimit Nr. 12, datë 30.06.2023, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë” dhe kalendarit të aplikimit universitar 2025,

U R D H Ë R O J:

- Organizimin e konkurseve, **Raundi i III-të** për ciklin e parë të studimeve Bachelor në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Arteve, të cilat kanë kuota të paplotësuara. Konkursët do të zhvillohen si më poshtë:
 - Regjistrimi i kandidatëve për konkursët e pranimiit në programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, sipas kuotave të lira të shpallura në U-Albania do të bëhet pranë sekretarive mësimore të fakulteteve, **deri më datë 20 tetor**.
 - Dokumentacioni për t’u regjistruar në konkursët e pranimiit është:
 - Mandati i pagesës së tarifës së konkurrimit;
 - Fotokopje e kartës së identitetit ose të pasaportës.
 - Konkursët e pranimiit për të gjitha programet e studimit që kanë kuota të paplotësuara do të zhvillohen në datat **21 – 22 tetor 2025**.
 - Më datë **22 tetor 2025 pas orës 16:00**, njësitë kryesore të UART të shpallin në vende të dukshme dhe të publikojnë në faqen elektronike zyrtare listat e kandidatëve fitues të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara në përputhje me kuotat e paplotësuara.
 - Më datë **23 tetor 2025 nga ora 08:00 deri në orën 16:00** do të kryhet regjistrimi i kandidatëve fitues pranë sekretarive mësimore të fakulteteve.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri anëtarët e grupit të monitorimit, dekanët e njësive kryesore, përgjegjësit e njësive bazë, sekretaritë mësimore të fakulteteve, dhe çdo strukturë tjetër në ndihmë të këtij procesi.
- Ky urdhër të shpallet në faqen elektronike zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli

